

**COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.**

**Pasqyrat Financiare  
në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

## Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur.....	i
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare:	
1. Entiteti raportues .....	5
2. Politika të rëndësishme kontabël.....	5
3. Vlerësime të rëndësishme kontabël dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël.....	16
4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara .....	17
5. Standarde dhe interpretime të reja.....	18
6. Aktive afatgjata materiale .....	19
7. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimi i qirasë .....	20
8. Investime në letra me vlerë të kapitalit .....	21
9. Huadhënie .....	21
10. Inventarët .....	22
11. Llogari të arkëtueshme.....	22
12. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura .....	22
13. Aktive të tjera .....	23
14. Depozita me afat .....	23
15. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre .....	23
16. Kapitali i paguar.....	24
17. Rezerva ligjore .....	24
18. Rezerva të tjera.....	24
19. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura.....	25
20. Llogari të pagueshme .....	25
21. Detyrime të tjera.....	26
22. Të ardhura nga kontratat me klientë.....	26
23. Të ardhura të tjera .....	26
24. Shpenzimet sipas natyrës .....	27
25. Shpenzime financiare neto .....	28
26. Tatim fitimi .....	28
27. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	30
28. Angazhime dhe detyrime të mundshme.....	35
29. Palët e lidhura.....	36
30. Ngjarje pas datës së raportimit.....	38
31. Politika kontabël për qiratë përpara 1 janar 2019.....	38

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.:

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përfshijnë raportin e menaxhimit dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

*Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.*

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.  
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri  
T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2242 639, [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar të raportojmë këtë çështje. Ne nuk kemi diçka për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

### Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.



Ne komunikojmë me drejtimin, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

  
PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.  
PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.  
7 prill 2020  
Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor  
Jonid Lamllari

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat janë ne lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Aktivitet</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	1,304,579,419	1,218,852,871
Aktive me të drejtë përdorimi	7	75,206,490	-
Investime në letra me vlerë të kapitalit	8	23,000,000	23,000,000
Huadhënie	9	243,540,000	185,130,000
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,646,325,909</b>	<b>1,426,982,871</b>
<b>Inventarët</b>			
Inventarët	10	293,793,769	208,053,099
Llogari të arkëtueshme	11	6,057,835	24,407,450
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	12	22,549,824	57,004,138
Aktive të tjera	13	61,530,035	58,245,642
Depozita me afat	14	395,310,000	458,216,840
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	15	435,313,267	176,163,265
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>1,214,554,730</b>	<b>982,090,434</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,860,880,639</b>	<b>2,409,073,305</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
Kapitali i paguar	16	1,493,040,000	1,493,040,000
Rezerva ligjore	17	29,987,807	29,987,807
Rezerva të tjera	18	41,264,800	41,264,800
Fitim i mbartur		678,485,253	486,763,484
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>2,242,777,860</b>	<b>2,051,056,091</b>
<b>Detyrimet e qirasë – afatgjata</b>			
Detyrimet e qirasë – afatgjata	7	23,486,722	-
Detyrime tatimore të shtyra	26	24,791,335	27,278,754
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>48,278,057</b>	<b>27,278,754</b>
<b>Detyrimet e qirasë- afatshkurtra</b>			
Detyrimet e qirasë- afatshkurtra	7	40,913,209	-
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19	8,784,416	14,251,691
Llogari të pagueshme	20	302,878,630	145,983,667
Tatim fitimi i pagueshëm	26	18,177,041	7,874,911
Detyrime të tjera	21	199,071,426	162,628,191
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>569,824,722</b>	<b>330,738,460</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>618,102,779</b>	<b>358,017,214</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>2,860,880,639</b>	<b>2,409,073,305</b>

Shënimet, ne faqet 5 deri 38, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Shumat në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2019	2018
Të ardhura nga shitjet	22	3,962,641,964	3,667,555,574
Kosto e mallrave të shitura	24	(2,390,477,920)	(2,307,615,878)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>1,572,164,044</b>	<b>1,359,939,696</b>
Të ardhura të tjera	23	262,158,857	220,508,758
Kosto të shpërndarjes	24	(701,561,083)	(644,056,742)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	24	(309,193,380)	(316,047,885)
Humbje të tjera, neto	24	(19,314,397)	(10,234,766)
		<b>(767,910,003)</b>	<b>(749,830,635)</b>
<b>Fitimi operativ</b>		<b>804,254,041</b>	<b>610,109,061</b>
Shpenzime financiare	25	(45,788,457)	(39,533,981)
Të ardhura financiare	25	43,709,306	4,695,609
Shpenzime financiare, neto		<b>(2,079,151)</b>	<b>(34,838,372)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>802,174,890</b>	<b>575,270,689</b>
Tatimi mbi fitimin	26	(123,689,637)	(88,507,205)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>678,485,253</b>	<b>486,763,484</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<b>678,485,253</b>	<b>486,763,484</b>

Shënimet, në faqet 5 deri 38, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K. janë aprovuar më datë 17 mars 2020 nga Bordi i Drejtorëve dhe u firmosën në emër të tyre nga drejtimi i Shoqërisë më 30 mars 2020 nga:

  
Ervina Kuta  
Drejtor i Financës dhe Administratës

  
Luigi Verardo  
Drejtor i Përgjithshëm



# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Shumat në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	407,711,488	1,972,004,095
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>					
Fitimi i vitit	-	-	-	486,763,484	486,763,484
Te ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	486,763,484	486,763,484
Shpërndarje dividend	-	-	-	(407,711,488)	(407,711,488)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	486,763,484	2,051,056,091
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	486,763,484	2,051,056,091
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>					
Fitimi i vitit	-	-	-	678,485,253	678,485,253
Te ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	678,485,253	678,485,253
Shpërndarje dividend	-	-	-	(486,763,484)	(486,763,484)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	678,485,253	2,242,777,860

Shënimet në faqet 5 deri 38, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Pasqyra e flukseve monetare

(Shumat ne lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	2019	2018
<b>Flukse monetare nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi i vitit:		678,485,253	486,763,484
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	6,7	213,581,570	142,943,934
Humbje neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	6	19,314,397	10,234,766
Zhvlerësimi i inventarëve	24	79,112,009	19,581,467
Fshirje të llogarive të arkëtueshme	11,12	-	4,399,933
Fshirje të llogarive të pagueshme	19,20	-	(3,182,901)
Të ardhura nga interesat	25	(7,747,681)	(3,810,009)
Të ardhura nga dividendët	25	(1,692,043)	(885,600)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	123,689,638	88,507,205
		<b>1,104,743,142</b>	<b>744,552,279</b>
<i>Ndryshime në:</i>			
Inventarë		(164,852,679)	(16,499,800)
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		34,454,314	28,695,532
Të drejta të arkëtueshme		18,349,615	(5,101,309)
Aktive të tjera		1,403,099	(33,685,938)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		(5,467,275)	(6,307,747)
Të pagueshme		72,645,607	(33,077,266)
Detyrime të tjera		36,443,235	11,682,326
<b>Mjete monetare nga aktivitetet operative</b>		<b>1,097,719,058</b>	<b>690,258,077</b>
Interesa të arkëtuar		3,060,189	2,135,863
Tatimi mbi fitimin i paguar		(115,874,927)	(89,834,151)
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet operative</b>		<b>984,904,321</b>	<b>602,559,789</b>
<b>Mjete monetare nga veprimtaritë investuese</b>			
Depozita me afat		62,906,840	99,583,160
Dividend i arkëtuar		1,692,043	885,600
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(168,551,737)	(235,636,514)
Të ardhura nga shitjet e pajisjeve dhe automjeteve		2,910,096	2,985,288
Huadhënie		(58,410,000)	(185,130,000)
<b>Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese</b>		<b>(159,452,758)</b>	<b>(317,312,466)</b>
<b>Mjete monetare nga veprimtaritë e financimit</b>			
Pagesa qiraje		(79,538,077)	-
Dividend të paguar	16	(486,763,484)	(407,711,488)
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>(566,301,561)</b>	<b>(407,711,488)</b>
Rritja/(pakësimi) neto i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		259,150,002	(122,464,165)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar	14	176,163,265	298,627,430
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor</b>	14	<b>435,313,267</b>	<b>176,163,265</b>

Shënimet në faqet 5 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 1. Entiteti raportues

Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K. ("Shoqëria") është themeluar në qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi S.r.l. ("ACIES"), shoqëria mëmë përfundimtare e cila është një shoqëri italiane me zyrat qendrore në Bolonja, Itali; The Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delaware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një shoqëri shqiptare me kapital shtetëror me zyrat qendrore në Tiranë, Shqipëri dhe themeluar në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria është angazhuar në prodhimin, mbushjen dhe shitjen e të gjitha produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas kontratës së Shoqërisë me The Coca-Cola Company (TCCC) dhe The Coca-Cola Export Corporation.

Ortakët e shoqërisë dhe pjesëmarrjet e tyre në kapital janë si më poshtë:

Ortakët	Në %	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
SIBEG Srl	74.69	74.69
TCCEC	22.65	22.65
INVEST P.F.	2.66	2.66
	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

Gjatë vitit 2019 nuk ka patur ndryshime në ortakët e Shoqërisë dhe në kuotat e tyre respektive.

Shoqëria është vendosur në Kashar, 5 km nga Tiranë (Shqipëri) me 346 punonjes me 31 dhjetor 2019 përfshirë punonjesit sezonal (2018: 347 punonjes).

### 2. Politika të rëndësishme kontabël

**Bazat e përgatitjes.** Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") duke u bazuar në kostot historike, përveç instrumenteve të kapitalit të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ").

Politikat kryesore të aplikuara për përgatitjen e pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Përveç ndryshimeve të politikave kontabël që rezultojnë nga miratimi i SNRF 16 "Qiratë" në fuqi nga 1 janari 2019, këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur përcaktohet ndryshe. Politikat kryesore të kontabilitetit të aplikuara për qiratë deri më 31 dhjetor 2018 janë paraqitur në Shënimin 31. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël. Kjo gjithashtu kërkon nga drejtimi i Shoqërisë që të ushtrojë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Zërat që kanë nevojë për gjykim të veçantë dhe kompleks si dhe zëra ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpjeguar në Shënimin 3.

**Përkthimi i monedhave të huaja.** Monedha funksionale e Shoqërisë është monedhë e mjedisit primar ekonomik në të cilin vepron njësia ekonomike. Monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e saj e prezantimit, është monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë ("lekë"). Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare janë përkthyer në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës të Shqipërisë ("BSh") në fund të periudhës përkatëse të raportimit. Humbjet dhe fitimet nga këmbimit valutor që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin zyrtar të këmbimit në fundvit sipas BSh, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, si të ardhura financiare ose shpenzime financiare. Humbjet dhe fitimet e kursit të këmbimit që kanë të bëjnë me huamarrjet dhe mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'të ardhurave financiare ose shpenzimeve financiare'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera të këmbimit valutor paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në 'Fitim / (humbje) të tjera, neto'. Përkthimi me normat e fund vitit nuk zbatohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, duke përfshirë edhe investimet e kapitalit, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj janë regjistruar si pjesë e fitimit dhe humbjes nga vlera e drejtë.

**Aktivitet Afatgjata Materiale.** Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto ose kosto të supozuar, minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin, kur është e nevojshme. Aktivitet afatgjata materiale përfshijnë aktivitet në proces për përdorim të ardhshëm si aktiv afatgjatë material.

Shpenzimet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitet ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur kemi siguri që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes ditore njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve të mëdha apo komponentë të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar ç' regjistrohet.

Në fund të çdo periudhe raportimi, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim të aktiveve afatgjata materiale. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivitet minus kostot e ç' regjistrimit dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje të vitit, për sa kohë që tejkalon tepicën e rivlerësimit të mëparshëm në kapitalin e vet. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktivitet në vitet e mëparshme anulohet kur konsiderohet e përshtatshme dhe nëse ka patur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitet në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimi.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël dhe njihen në fitim ose humbje për vitin në 'fitim / (humbje) të tjera, neto'.

**Amortizimi.** Toka dhe aktivitet ne proces nuk amortizohen. Jeta e dobishme e tokës me qira është 99 vjet dhe amortizohet me 1.01% duke përdorur metodën lineare. Amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston dhe vlerën e mbetur të tyre sipas jetëgjatësisë së dobishme:

E drejta e përdorimit të tokës	1.01%
Ndërtesa dhe instalime	2.5%
Makineri dhe pajisje	20%
Automjete	20%
Ambalazhe të riciklueshme dhe frigoriferë	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	20 – 25%

Vlera e mbetur e një aktivitet është shuma e vlerësuar që Shoqëria do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivitet minus kostot e vlerësuar për ta nxjerrë jashtë përdorimit, në qoftë se aktivitet është tashmë në moshën dhe në kushtet e pritshme në fund të jetës së tij të dobishme. Vlera e mbetur e aktivitet dhe jeta e dobishme rishikohen, dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportimi.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

**Aktivitet me të drejtë përdorimi.** Shoqëria merr me qira ndërtesat, fasadat dhe automjetet. Kontratat mund të përmbajnë komponentë qiraje dhe jo-qiraje. Shoqëria e ndan vlerësimin në kontratë për komponentët e qirasë dhe jo-qirasë bazuar në çmimet e tyre të pavarura relative. Sidoqoftë, për qiratë e automjeteve për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qirasë dhe të jo-qirasë, por i llogarit këto si një komponent të vetëm të qirasë.

Aktivitet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten në bazë të vlerës aktuale.

Aktivitet e me të drejtë përdorimi maten me kosto që përmban si vijon:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë e kryer në ose para datës së fillimit të qirasë, pa përfshirë çdo incitivë të përftuar,
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e aktivitet në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

Aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohen me vlerën më të vogël mes jetës së dobishme të aktivitet dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është e sigurt për të ushtruar një mundësi blerjeje, aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohet për jetën e dobishme të aktiveve kryesore. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me ndërtesat dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të qirasë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me pajisjet dhe kanë një afat qiraje të pacaktuar, llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar prej 5 vjetësh.

	<u>Jeta e dobishme në vite</u>
Ndërtesa	5
Fasada	3
Automjete	1 deri në 4

**Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.** Aktivitet afatgjata jo-materiale që kanë një jetë të dobishme të papërcaktuar ose aktivitet afatgjata jo-materiale jo të gatshme për përdorim nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësim. Aktivitet që i nënshtrohen zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera kontabël neto mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivitet tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e një aktivitet minus kostot e ç'registrimit dhe vlerës në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit, aktivitet grumbullohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka hyrje monetare kryesisht të pavarura (njësi gjeneruese të mjeteve monetare). Zhvlerësimet e mëparshme të aktiveve jo financiare (përveç emrit të mirë), nëse ka, shqyrtohen për kthim të mundshëm në çdo datë raportimi.

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

*Instrumentet financiare - termat kryesore të matjes.* Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm mbi çmimet.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose detyrimin individual dhe numrin e instrumenteve të mbajtura nga njësisia ekonomike. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal i tregtisë ditore të një tregu nuk është i mjaftueshëm për të përvetësuar sasinë e mbajtur dhe vendosja e porosive për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknika vlerësimi, siç janë modeli i flukseve të zbritshme të parasë ose modeli i transaksioneve të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të lidhura me njëra-tjetrën ose konsiderimi i të dhënave financiare të investitorëve, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve financiarë të caktuar për të cilët informacioni për çmimet e tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) matjet e nivelit të parë janë matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika vlerësimi me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, ose në mënyrë direkte (si çmime) ose indirekte (rrjedh nga çmimet), dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhëna të vëzhgueshme të tregut (d.m.th., matja kërkon inpute domethënëse të pa verifikueshme)

Flukset e pritshme monetare përfshijnë pagesat e principalit dhe interesit gjatë gjithë jetës së huasë në periudha vjetore që nga data e bilancit. Shoqëria ka marrë në konsideratë kohën e pagesës së principalit dhe interesit. Flukset monetare nga interesat janë llogaritur duke përdorur normën efektive të interesit.

*Kostot e transaksionit* janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit të një instrumenti financiar. Një kosto shtesë nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifatat dhe komisionet e paguara për agjentët (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë të shitjes), konsulentët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë, dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet ose skontimet e borxhit, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

*Kostoja e amortizuar ("KA")* është shuma me të cilën instrumenti financiar është regjistruar në njohjen fillestare minus çdo pagesë principali, plus interesin e përlllogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo vlerë të zbritshme për humbjet e pritura të kredisë ("HPK"). Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksioneve të shtyra në njohjen fillestare dhe çdo prim ose skontim të shumës së maturimit duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Të ardhurat e përlllogaritura nga interesi dhe shpenzimet e përlllogaritura të interesit, që përfshijnë si kuponin e përlllogaritur po ashtu dhe skontimin ose primin e amortizuar (përfshirë tarifat e shtyra në origjinë, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të artikujve përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

*Metoda e interesit efektiv* është një metodë e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit për periudhën përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) mbi vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma me të cilën skontohehen pagesat e ardhshme në para (pa përfshirë humbjet e ardhshme të huasë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose për një periudhë më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël bruto të instrumentit financiar.

Norma e interesit efektiv skonton flukset monetare të instrumenteve me interes variabël deri në datën e ardhshme të rivlerësimit të interesit, përveç primit ose skontimit që pasqyron marzhin e huasë mbi normën e luhatshme të specifikuar në instrument, ose variablat e tjerë që nuk janë përcaktuar në normat e tregut. Primit ose skontimet e tilla amortizohen gjatë gjithë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale paraqet të gjitha tarifat e paguara ose të pranuar ndërmjet palëve në kontratë që janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Për aktivet financiare të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim ("POCI") në njohjen fillestare, norma efektive e interesit rregullohet për rrezikun e huasë, pra llogaritet duke u bazuar në flukset e pritshme monetare në njohjen fillestare në vend të pagesave kontraktuale.

*Instrumentet financiare - njohja fillestare.* Instrumentet financiare të Shoqërisë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë, të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshkohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të dëshkohet nga transaksionet e tjera të tregut për të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e të cilave përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Pas njohjes fillestare, një zbritje e humbjes së pritshme të kredisë ("HPK") njihet për aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar ("KA") dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") që rezultojnë në një humbje të menjëhershme të kontabël.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarje brenda afatit të përcaktuar me rregullore ose konventë të tregut ("mënyrë e rregullt" e blerjeve ose shitjeve) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Shoqëria merr përsipër të dorëzojë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria përdor teknikën e vlerësimit të flukseve të skontuara të mjeteve monetare për të përcaktuar vlerën e drejtë të huave ndaj palëve të lidhura që nuk tregtohen në një treg aktiv. Mund të lindin diferenca midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare, e cila konsiderohet të jetë çmimi i transaksionit, dhe shumës që përcaktohet në njohjen fillestare duke përdorur një teknikë vlerësimi me inpute të nivelit 3. Nëse mbeten diferenca pas kalibrimit të inputeve të modelit, këto diferenca amortizohen mbi baza lineare mbi afatin e huave ndaj palëve të lidhura. Nëse vlerësimi përdor vetëm inputet e nivelit 1 ose të nivelit 2, diferenca njihen menjëherë në fitim ose në humbje.

*Aktivet financiare –klasifikimi dhe matje e mëpasshme–kategoritë e matjes.* Shoqëria i klasifikon aktivet financiare sipas kategorive të mëposhtme të matjes: VDFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja e mëpasshme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit që ndjek Shoqëria për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e flukseve monetare të aktivitetit.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

**Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasshme – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Shoqëria menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm të mbledhë flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajnë për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("mbajnë për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe shesin") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit, atëhere klasifikohen si "të tjerë" dhe maten në VDFH.

Modeli i biznesit për një grup të aktiveve (në nivel portofoli) përcaktohet duke u bazuar në të gjitha evidencat përkatëse në lidhje me aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e përcaktuar për portofolin në dispozicion në datën e vlerësimit. Kushtet që Shoqëria konsideron në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë përberjen dhe qëllimin e një portofoli, përvojën e mëparshme mbi mbledhjen e flukseve monetare të aktiveve përkatëse.

**Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasshme – karakteristikat e flukseve monetare.** Kur modeli i biznesit do të mbajë pasuri për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Aktivet financiare me derivativët e përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktojnë nëse flukset e tyre të parasë janë në përputhje me tiparin e VPPI. Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e huasë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDFH.

Kur emetuesit mund ti kërkohet të shtyjë pagesat e interesit dhe interesi shtesë nuk përlllogaritet në këto shuma të shtyra të interesit, shumat e interesit nuk merren në konsideratë për vlerën në kohë të parasë për shumën e principalit të papaguar, rrjedhimisht aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDFH.

**Aktivet financiare – riklasifikimi.** Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria gjatë periudhës aktuale nuk e ka ndryshuar modelin e biznesit dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim. Në 1 janar 2018, Shoqëria vlerësoi investimin në instrumenta kapitali me VDATGJ. Në 2017, investimi u klasifikua si aktiv i vlefshëm për shitje dhe u mat me kosto (Nota 7).

#### **Zhvlerësimi i aktiveve financiare – zbritja për humbjen e kredisë për HPK.**

Shoqëria ndjek një qasje të thjeshtuar për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve nga qiraja dhe atyre tregtare. Për zhvlerësimin e aktiveve të tjera financiare Shoqëria ndjek një model me tre faza, bazuar në ndryshimet e cilësisë së huasë që nga njohja fillestare. Një instrument financiar që nuk është zhvlerësuar në njohjen fillestare klasifikohet në Fazën 1. Përlllogaritja e HPK për aktivet financiare në Fazën 1 bëhet në vlerën e cila është e barabartë me atë pjesë të HPK përgjatë jetës që vjen si rezultat i ngjarjeve të mundshme të dështimit brenda 12 muajve ose deri në afatin e kontratës, nëse kjo është më e shkurët (HPK 12 muaj). Nëse Shoqëria identifikon një rritje të konsiderueshme të rrezikut të huasë ("SICR") që nga njohja fillestare, aktivi transferohet në Fazën 2, dhe HPK e tij matet duke u bazuar në HPK-në përgjatë jetës, që vazhdon deri në afatin e kontratës por duke konsideruar parapagimet e pritura, nëse ka ("HPK Përgjatë jetës"). Nëse Shoqëria përcakton se aktivi financiar është i zhvlerësuar, aktivi transferohet në Fazën 3 dhe HPK e tij matet si HPK përgjatë jetës. Për aktive financiare që janë blerë apo krijuar të zhvlerësuar ("Aktivet POCI"), HPK-ja matet gjithmonë si një HPK përgjatë jetës.

Shoqëria nuk llogarit HPK për depozitat me afat duke supozuar se probabiliteti i dështimit është thujse zero, kështu nuk do të kishte ndikim material në pasqyrat financiare.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

Me të njejtën logjikë, Shoqëria nuk llogarit HPK për huatë ndaj palëve të lidhura, pasi rreziku i kredisë mund të trajtohet në bazë të kompesimit të plotë nëpërmjet dividendëve të ardhshëm të pagueshëm ndaj Shoqërisë mëmë. Në të dy rastet, Shoqëria do të konsiderojë HPK nëse vlerësimi i kredisë për palët sipas agjensive ndërkombëtare të vlerësimit do të përkeqësohet me më shumë se dy nivele.

**Aktivet financiare -fshirja.** Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka bërë të gjitha përpjekjet praktike për arkëtimin e tyre dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shpresa të arsyeshme për arkëtim. Fshirja përfaqëson një ngjarje të ç'regjistrimit. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së mbledhjes me forcë kur Shoqëria kërkon të rimarrë shumat të cilat sipas kontratës janë të kërkueshme, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për arkëtim.

**Aktivet financiare - ç'regjistrimi.** Shoqëria i ç'regjistron aktivet financiare kur (a) aktivet janë shlyer ose të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi kanë skaduar ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukse të mjeteve monetare nga aktivi ose ka marrë detyrimin për të paguar flukset monetare të marra në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshjeje të "kalimit" (i) gjithashtu ka transferuar në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, ose (ii) nuk ka transferuar as nuk ka ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin ndaj një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në shitje.

**Detyrimet financiare –kategoritë e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me KA, përveç (i) detyrimeve financiare në VDHF: ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet afatshkurtra në letra me vlerë), konsiderata kontingjente e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – ç'regjistrimi.** Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur ato shuhet (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë është përmbushur anuluar ose i ka kaluar afati).

**Detyrimet financiare të përcaktuara në VDFH.** Shoqëria mund të përcaktojë disa detyrime në VDFH në njohjen fillestare. Fitimet dhe humbjet nga këto detyrime paraqiten në fitim ose humbje përveç shumës së ndryshimit në vlerën e drejtë që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit të këtij detyrimi (përcaktuar si shuma që nuk i atribuohet ndryshimeve të kushteve të tregut që shkaktajnë rritje të rrezikut të tregut), e cila regjistrohet në OCI dhe nuk riklasifikohet më pas si fitim apo humbje. Në rastet kur një prezantim i tillë do të krijonte, apo do të zgjeronte një mospërputhje kontabël, fitimet dhe humbjet që i atribuohen ndryshimeve në rrezikun e kreditit të detyrimeve, gjithashtu paraqiten në fitim ose humbje.

**Kompensimi i instrumentave financiarë.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e ligjshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka si qëllim ose shlyerjen në bazë neto, ose realizimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit në të njejtën kohë. Kjo e drejtë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e ligjshme në të gjitha rrethanat në vijim (i) në rrjedhën normale të biznesit (ii) në rastet e dështimit dhe (iii) në rastet e paaftësisë paguese ose falimentimit.



# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

**Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.** Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me kosto të amortizuara sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare përfaqësojnë VPPI, dhe (ii) ato nuk janë caktuar me VDFH.

**Depozita me afat.** Depozitat me afat me maturitet mbi tre muaj mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

**Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.** Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me KA duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

**Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera.** Llogaritë e pagueshme tregtare njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës, fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me KA duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

**Huatë.** Huatë njihen fillimisht me vlerë të drejtë, neto nga kostot të ndodhura të transaksioneve, dhe në vazhdimësi maten me KA duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv. Kompania nuk ka hua në datën e raportimit.

**Garancitë financiare.** Garancitë financiare kërkojnë që Shoqëria të kryejë pagesa të specifikuar për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ajo i shkakton nëse një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesat në përputhje me kushtet origjinale ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, gjë që zakonisht dëshkohet nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në bazë të metodës lineare përgjatë jetës së garancisë. Në fund të çdo periudhe raportimi, garancitë maten në nivelin më të lartë të (i) shumës së humbjes së zbritshme për ekspozimin e garantuar, të përcaktuar bazuar në modelin e humbjes së pritshme dhe (ii) gjendjes së mbetur të pazhvlerësuar të shumës në njohjen fillestare. Për më tepër, humbja e zbritshme HPK njihet për tarifën e arkëtueshme që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv. Kompania nuk ka garanci financiare në datën e raportimit.

**Detyrime të qirasë.** Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave të mëposhtme:

- pagesa fikse (përfshirë pagesa fikse thelbësore), të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë,
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit
- shumat e pritshme për t'u paguar nga Shoqëria sipas vlerës së mbetur të garancive,
- çmimi i ushtrimit të opsionit të blerjes nëse Shoqëria është e sigurt për ushtrimin e këtij opsioni., dhe
- pagesat e penalteteve për përfundimin e qirasë, nëse Shoqëria mendon ta ushtrojë këtë opsion.

Mundësitë e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në mënyrën e aseteve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyrjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e shtyrjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

Pagesat për qiranë janë të skontuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrtë hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e aktivitetit me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën e huamarrjes Shoqëria përdor normat e interesit të bankave të niveli të dytë duke marrë në konsideratë afatin, shtetin, monedha, kolateralet dhe kushte të tjera.

Pagesat për qiranë shpërndahen midis principalit dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në pasqyrën fitimit ose humbjes gjatë periudhës së qirasë financiare në mënyrë që të krijohet një normë periodike interesi mbi balancën e mbetur të detyrimit pergjatë çdo periudhe.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtëra të aktiveve dhe të gjitha qiratë për aktivet me vlerë të vogël njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Qiratë afatshkurtëra janë qira me kohëzgjatje prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të vogël janë aktive me vlerë 5,000 euro ose më pak. Shoqëria nuk ka qira me vlerë të vogël më 31.12.2019.

Për te optimizuar kostot përgjatë kohëzgjatjes së kontratës Shoqëria ndonjëherë krijon garanci në vlerën e mbetur për qiratë e pajisjeve. Shoqëria fillimisht llogarit dhe njuh shumën e pritshme për tu paguar nën garacinë e vlerës së mbetur si pjesë e detyrimit për qiranë. Zakonisht vlera e mbetur e pritshme në fillim të qirasë është e barabartë ose me e lartë se vlera e garancisë dhe Shoqëria nuk pret të ketë ndonjë pagesë shtesë. Në fund të çdo periudhe raportuese vlera e mbetur rishikohet dhe ndryshohet për të reflektuar vlerën aktuale të mbetur në bazë të aktiveve të tjera të krahasueshme dhe parashikimeve për çmimet në të ardhmen.

**Tatimet mbi fitimin.** Tatimet mbi fitimin janë raportuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Taksa e tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse kjo është njohur në kapitalin neto ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimin nëse pasqyrat financiare janë autorizuar para se të dorëzohen deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave përllogaritet duke përdorur metodën e pasivitetit të bilancit për humbjet tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as fitimin kontabël as atë të tatueshëm. Balancat tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura substancialisht në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore e mbartur.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe detyrimet tatimore të mbartura regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitim i mjaftueshëm i ardhshëm, i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompesuar aktivet tatimore kundrejt detyrimeve tatimore dhe kur aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra lidhen me tatimin mbi të ardhurat të përcaktuara nga i njëjti autoritet tatimor dhe ka një qëllim për të shlyer balancat mbi baza neto.

**Pozicionet e pasigurta tatimore.** Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse këto pozicione do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratohen në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, si dhe vendime të njohura nga gjykatat mbi çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe detyrimet tatimore të tjera nga të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç interesave dhe gjobave, regjistrohen brenda tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesat dhe gjobat, regjistrohen neto brenda shpenzimeve financiare dhe fitim/(humbjeve) të tjera, përkatësisht.

**Tatimi mbi vlerën e shtuar.** Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të hershëm se, (a) grumbullimin e kërkesave të arkëtueshme nga klientët ose (b) lëvrimin e mallrave ose shërbimeve tek klientët. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikuperohet kundrejt TVSH-së së shitjeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe jepet si informacion shpjegues veçmas si një aktiv dhe pasiv. Aty ku është bërë një provigjion për HPK të arkëtueshme, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

**Parapagimet.** Parapagimet mbahen me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet të cilat lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti, ose kur parapagimi lidhet me një aktiv, i cili do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël të aktivit pasi Shoqëria të ketë marrë kontrollin e aktivit dhe pritet që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Parapagimet e tjera pakësohen në fitim ose humbje kur merren shërbimet e lidhura me parapagimet. Nëse ekziston një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet në lidhje me një parapagim nuk do të merren, vlera kontabël e parapagimit zhvlerësohet në përputhje me rrethanat dhe humbja përkatëse nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

**Kapitali.** Aksionet e zakonshme dhe aksionet preferenciale të pa-tërheqshme me dividendë të papërcaktuar klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, mbi të ardhurat. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si premium i aksioneve në kapital.

**Dividendët.** Dividentët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, janë të shpalosura në shënimet e ngjarjeve të mëvonshme.

**Provizionet për detyrimet dhe tarifat.** Provizionet për detyrimet dhe tarifat janë detyrime jo-financiare ku koha dhe vlera janë të pasigurta. Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provizioni matet me vlerën aktuale të shpenzimeve që duhen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim i interesit në shpenzimet financiare.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

**Inventarët.** Inventarët regjistrohen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston first-in, first-out. Në rastin e inventarëve të prodhuar apo prodhimit në proces, në kosto përfshihet pjesa e shpenzimeve të përgjithëshme në bazë të kapacitetit normal operativ.

**Përfitimet e punonjësve.** Përfitimet afatshkurtra të punonjësve – Përfitimet afatshkurtra të punonjësve njihen si shpenzim kur jepen shërbimet e lidhura. Detyrimi njihet për pjesën e pritshme për tu paguar nëse Shoqëria ka detyrim ligjor ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i një shërbimi të shkuar nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

**Fondet e detyrueshme** – Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa për llogari të vetë dhe të punonjësve për të kontribuar në fondet e detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin

**Provizionet.** Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme që pritet të ndodhin me një normë para tatimit që tregon vlerësimet aktuale të tregut mbi vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet e lidhura me detyrimin. Provizionet shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që do të kërkohej një fluks dalës i burimeve që përbëjnë përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Provizionet nuk njihen në humbjet e ardhshme operative.

**Njohja e të ardhurave.** Të ardhurat vijnë si rrjedhojë e aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në çmimin e transaksionit. Çmimi i transaksionit është ai që shoqëria pret të ketë të drejtë të arkëtojë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto ndaj uljeve tregtare, kthimeve dhe tatimit mbi vlerën e shtuar, tarifave të eksportit, akcizave, pagesave të tjera të ngjashme detyrueshme.

**Shitja e mallrave.** Shitjet njihen kur kontrolli mbi mallin është transferuar, në momentin kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, i cili ka liri të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendndodhjen specifike, rreziqet e dëmtimit dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, kriteret e pranimit janë plotësuar ose Shoqëria ka bindjen objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Të ardhurat nga shitjet me ulje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, duke zbritur uljet e parashikuara lidhur me volumet. Eksperienca e akumuluar përdoret për të vlerësuar dhe siguruar uljet, duke përdorur metodën e vlerës së pritshme dhe të ardhurat njihen vetëm në masën për të cilën ka siguri se sdo të ndodhin ndryshime të rëndësishme. Një detyrim rimbursimi njihet për uljet e pritshme të vëllimit të pagueshëm për klientët në lidhje me shitjet e bëra deri në fund të periudhës raportuese.

Asnjë element i financimit nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat shlyerje prej 10 deri në 30 ditë, që është në përputhje me praktikën e tregut. Një e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi kjo është pika në kohë që shqyrtimi është i pakushtëzuar, sepse kërkohej vetëm kalimi i kohës përpara se të bëhet pagesa.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdimi)

*Rimbursimi i kostove për programet e marketingut.* Rimbursimet e programeve të marketingut për të promovuar shitjen e produkteve të licencuara njihen si të ardhura në vitin në të cilin ndodhin shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove të shitjes njihet si e ardhur në të njëjtën kohë me shitjen e produkteve të cilave i referohet.

### 3. Vlerësime të rëndësishme kontabël dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël

Shoqëria bën vlerësime, dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara në pasqyrat financiare të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve gjatë vitit fiskal pasardhës. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorëve të tjerë, përfshirë pritshmëritë mbi ngjarje të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme për rrethanat aktuale. Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

*Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale.* Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale është çështje gjykimi bazuar në eksperiencën me aktive të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin konsumohen përgjatë përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë siç janë vjetërsimi teknik ose tregtar, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të lidhura me aktivet. Drejtimi vlerëson jetën e dobishme të mbetur në përputhje me kushtet teknike aktuale të aktiveve dhe periudhës së parashikuar gjatë së cilës aktivet pritet të krijojnë përfitime për Shoqërinë. Konsiderohen faktorët kryesorë të mëposhtëm: (a) përdorimi i pritshëm i aktiveve; (b) konsumimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacional dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që vjen si rrjedhojë e ndryshimeve në kushtet e tregut.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara

**SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore në ose pas 1 janar 2019)**

Shoqëria miratoi SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive të adoptimit me datën e aplikimit fillestar të 1 janarit 2019, pa riparaqitur shifrat krahasuese dhe duke përdorur disa lehtësira të lejueshme nga standardi. Të gjitha aktivet me të drejtë përdorimi maten në vlerën e detyrimit të qirasë në momentin e miratimit (rregulluar për parapagime ose shpenzime të shtyra).

Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë, Shoqëria ka përdorur mjetet e mëposhtme praktike në tranzicion të lejuara nga standardi:

- duke u mbështetur në vlerësimet e mëparshme nëse qiratë janë të mëdha si një alternativë për të performuar një rishikim zhvlerësimi- nuk ka patur kontrata me vlerë të madhe më 1 janar 2019.
- llogaritjen e qirave operative me një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga 1 janari 2019 si qira afatshkurtra,,
- duke përjashtuar kostot fillestare direkte për matjen e aktivitetit me të drejtë përdorimi në datën e aplikimit fillestar, dhe
- duke përdorur mbikëqyrje në përcaktimin e afatit të qirasë, kur kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos rivlerësojë nëse një kontratë është ose përmban një qira në datën e aplikimit fillestar. Në vend të kësaj, për kontratat e lidhura përpara datës së tranzicionit Shoqëria është mbështetur mbi vlerësimin e bërë me aplikimin e SNK 17, Qiratë dhe KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një "qira",

Norma mesatare rritëse e huamarrjes e aplikuar nga Shoqëria për detyrimet e qirasë më 1 janar 2019 ishte 3.2%

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte angazhime qiraje të pakthyeshme prej 117,464,441 lekë, prej të cilave 307,316 lekë qira afatshkurtra të njohura në bazë lineare si shpenzim në fitim ose humbje.

Një krahasim i angazhimeve të qirasë operative të paraqitura në shënimin 29 për detyrimin e njohur është si më poshtë:

	<b>1 janar 2019</b>
Pagesat minimale të ardhëshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme* më 31 dhjetor 2018	117,464,441
- Detyrimet e qirasë financiare të njohura më 31 dhjetor 2018	-
- Pagesa të ardhëshme të qirasë, rezultat i një trajtimi të ndryshëm i opsioneve të zgjatjes apo përfundimit	-
- Pagesa të ardhëshme variabël të qirasë të bazuara në një indeks ose normë	-
- Efekti i skontimit në vlerë aktuale	(3,733,695)
- Minus qiratë afatshkurtra jo të njohura si detyrim	(307,316)
- Minus qiratë me vlerë të ulët jo të njohura si detyrim	-
<b>Totali i detyrimit të qirasë i njohur më 1 janar 2019</b>	<b>113,423,430</b>
Nga të cilat:	
Detyrime qiraje afatshkurtër	66,245,598
Detyrime qiraje afatgjatë	47,177,832

\* Qiratë e paanullueshme përfshijnë vetëm ato që janë të anullueshme (a) nëse shfaqet një kusht i largët, (b) me aprovimin e qiradhënësit, (c) nëse qiramarrësi hyn në një kontratë të re për një aktiv të njejtë ose të ngjashëm ose (d) nëse ka pagesa nga qiramarrësi për këtë vlerë shtesë, që në fillim të qirasë dhe vazhdimësia e saj është siguri e arsyeshme.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)1

Ndryshimi në politikat kontabël ndikoi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar më 1 janar 2019 si më poshtë:

#### Impakti i zbatimit të SNRF 16

Rritje në aktivet me të drejtë përdorimi	123,371,576
Ulje në parapagime	(9,948,146)
Rritje në detyrimet e qirasë	113,423,430

*Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janari 2019, por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri.*

- KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat" (lëshuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (lëshuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët" (lëshuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësime Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (lëshuar në 12 dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (lëshuar në 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

### 5. Standarde dhe interpretime të reja

*Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja, të cilat janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020 të cilat Shoqëria nuk i ka miratuar më herët*

Ndryshimet e rëndësishme për Shoqërinë, për të cilat nuk pritet të ketë impakt në pasqyrat financiare janë si më poshtë

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Ndërmarrjes Ndihmëse të tij ose Ndërmarrjes së Përbashkët Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (lëshuar në 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohen nga BSNK)..
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2021).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (lëshuar në 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020)..
- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (lëshuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020). Kuadri Konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi matjen, udhëzim mbi raportimin e performancës financiare, udhëzime dhe përkufizime të përmirësuara- në veçanti përkufizimi i një detyrimi dhe qartësime mbi çështje të caktuara, siç janë rolet e drejtimit, kujdesi dhe pasiguria në matje në raportimin financiar.

# COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 6. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Toka	E drejta e përdorimit të tokës	Ndërtesa dhe instalime	Makinëri dhe pajisje	Mjete transporti	Ambalazh i rikthyeshëm dhe pajisje ftohëse	Mobilije dhe pajisje zyre	Të tjera	Punime në proces	Totali
<b>Kosto</b>										
Më 1 janar 2018	17,455,602	62,700,000	827,351,967	1,390,224,229	52,976,002	446,724,974	146,550,404	5,089,390	3,761,005	2,952,833,573
Shtesa	168,000	-	50,463,575	72,479,627	-	104,693,860	6,975,727	842,048	13,677	235,636,514
Transferime	-	-	1,982,197	-	-	-	-	-	(1,982,197)	-
Pakësime	-	-	-	(2,693,714)	(1,584,042)	(757,095)	-	-	-	(5,034,851)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(25,898,610)	(404,896)	(22,769,188)	(10,936,587)	(165,431)	-	(60,174,712)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>17,623,602</b>	<b>62,700,000</b>	<b>879,797,739</b>	<b>1,434,111,532</b>	<b>50,987,064</b>	<b>527,892,551</b>	<b>142,589,544</b>	<b>5,766,007</b>	<b>1,792,485</b>	<b>3,123,260,524</b>
Shtesa	420,000	-	28,533,286	68,743,868	130,724	88,142,649	23,139,134	683,147	43,008,285	252,801,093
Transferime	-	-	-	13,677	-	-	-	-	(13,677)	-
Pakësime	-	-	-	(1,104,250)	(809,791)	(6,564,088)	-	-	-	(8,478,129)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	(1,669,620)	(43,966,017)	(12,875,675)	(28,859,189)	(22,516,522)	(105,630)	-	(109,992,653)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>18,043,602</b>	<b>62,700,000</b>	<b>906,661,405</b>	<b>1,457,798,810</b>	<b>37,432,322</b>	<b>580,611,923</b>	<b>143,212,156</b>	<b>6,343,524</b>	<b>44,787,093</b>	<b>3,257,590,835</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>										
Më 1 janar 2018	-	(15,198,480)	(290,700,744)	(1,130,439,898)	(42,382,324)	(226,791,187)	(107,803,541)	(137,054)	-	(1,813,453,228)
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(13,714,673)	(57,710,983)	(2,023,024)	(58,770,451)	(10,091,533)	-	-	(142,943,934)
Pakësime	-	-	-	2,162,387	956,441	360,874	-	-	-	3,479,702
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	24,312,389	237,035	15,213,411	8,732,618	14,354	-	48,509,807
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>(15,831,750)</b>	<b>(304,415,417)</b>	<b>(1,161,676,105)</b>	<b>(43,211,872)</b>	<b>(269,987,353)</b>	<b>(109,162,456)</b>	<b>(122,700)</b>	<b>-</b>	<b>(1,904,407,653)</b>
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(14,464,664)	(55,375,701)	(1,544,240)	(62,583,435)	(10,248,742)	-	-	(144,850,052)
Pakësime	-	-	-	609,206	536,146	5,238,426	-	-	-	6,383,778
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	816,066	38,823,911	11,992,595	20,822,505	17,407,434	-	-	89,862,511
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>(16,465,020)</b>	<b>(318,064,015)</b>	<b>(1,177,618,689)</b>	<b>(32,227,371)</b>	<b>(306,509,857)</b>	<b>(102,003,764)</b>	<b>(122,700)</b>	<b>-</b>	<b>(1,953,011,416)</b>
<b>Vlera kontabël</b>										
Më 1 janar 2018	17,455,602	47,501,520	536,651,223	259,784,331	10,593,678	219,933,787	38,746,863	4,952,336	3,761,005	1,139,380,345
Më 31 dhjetor 2018	17,623,602	46,868,250	575,382,322	272,435,427	7,775,192	257,905,198	33,427,088	5,643,307	1,792,485	1,218,852,871
Më 31 dhjetor 2019	18,043,602	46,234,980	588,597,390	280,180,121	5,204,951	274,102,072	41,208,392	6,220,824	44,787,093	1,304,579,419



# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

E drejta e përdorimit të tokës përfaqëson kontributin në natyrë nga aksioneri, Invest P.F në kapitalin e nënshkruar. E drejta e përdorimit të tokës në të cilën ndodhet ndërtesa e Shoqërisë është e vlefshme për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet që nga fillimi i aktivitetit të Shoqërisë. Të drejtës së përdorimit i mbaron afati në vitin 2092 dhe ka një amortizim vjetor 633,270 Lek.

#### *Sigurimi*

Nuk ka ndonjë aktiv afatgjatë material të lënë si kolateral për ndonjë kredi deri më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

#### *Amortizimi*

Amortizimi është alokuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime si më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Kosto e shitjes	83,874,025	87,341,418
Kosto e shpërndarjes	50,727,285	45,510,983
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	10,248,742	10,091,533
	<u>144,850,052</u>	<u>142,943,934</u>

### 7. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimi i qirasë

Shoqëria merr me qira ndërtesa, pajisje dhe automjete. Kontratat e qirasë kanë afat të përcaktuar, por kanë mundësi zgjatje afati.

Deri më 31 dhjetor 2018, kontratat e qirasë së aktiveve afatgjata materiale kanë qenë të klasifikuara si qira financiare ose qira operative. Duke filluar nga 1 janar 2019, qiratë janë njohur si aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim qiraje koresponduese, nga data që aktivi merret në përdorim nga Shoqëria.

	Ndërtesa	Automjete	Fasada	Totali
<b>Vlera kontabël më 1 janar 2019</b>	<b>21,653,256</b>	<b>101,718,320</b>	-	<b>123,371,576</b>
Shtesa	-	4,328,460	16,237,973	<b>20,566,433</b>
Pakësime (modifikime qiraje)	-	-	-	-
Amortizim	(5,413,308)	(62,972,722)	(345,489)	<b>(68,731,518)</b>
<b>Vlera kontabël më 31 dhjetor 2019</b>	<b>16,239,948</b>	<b>43,074,058</b>	<b>15,892,484</b>	<b>75,206,490</b>

Shoqëria ka njohur detyrime qiraje si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>01.01.2019</u>
Detyrime qiraje afatshkurtra	40,913,209	66,245,598
Detyrime qiraje afatgjata	23,486,722	47,177,832
<b>Total detyrime qiraje</b>	<b>64,399,931</b>	<b>113,423,430</b>

Shpenzimet e lidhura me aktivet afatshkurtra të qirasë (të përfshira në shpenzime të tjera operative) janë 307,316 lekë.

Shpenzime interesi, të përfshira në shpenzime financiare të vitit 2019 janë 2,649,452 lekë.

Totali i flukseve monetare dalëse për qira në vitin 2019 është 72,127,415 lekë.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 8. Investime në letra me vlerë të kapitalit

Investimi prej 23,000,000 lekë përfaqëson 2.16% (2018: 2.16%) investim të Shoqërisë në kapitalin e nënshkruar të UJI I FTOHTË TEPELENA SH.P.K., një Shoqëri e ambalazhimit të ujit në Shqipëri, Shoqëria mëmë përfundimtare e së cilës është ACIES.

Më 1 janar 2018, Shoqëria përcaktoi investimin si letër me vlerë të kapitalit në VDATGJ pasi investimi pritet të mbahet për qëllime strategjike dhe jo për qëllime fitimi nga një shitje e mëpasshme, dhe nuk ka qëllim shitje në periudhë afatshkurtër apo afatmesme. Objektivi i investimit është mbajtja e aktivitetit në periudhë afatgjatë për qëllime strategjike. Vlera kontabël më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfaqëson vlerën e drejtë në datën e raportimit.

Investimi më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Investime në letra me vlerë të kapitalit	23,000,000	23,000,000
<b>Totali</b>	<b><u>23,000,000</u></b>	<b><u>23,000,000</u></b>

Investimi strategjik nuk ka patur pakësime gjatë vitit 2019, dhe nuk ka patur transferime ose fitim/humbje kumulative me kapitalin e lidhur me këtë investim.

Te ardhura nga dividendët e arkëtuar gjatë 2019 janë 1,692,043 lekë (2018: 885,600 lekë)

### 9. Huadhënie

Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka lidhur një marrëveshje huaje me ACIES me afat maturimi të datës 31 dhjetor 2024 dhe ka një interes vjetor me një normë të luhateshme të Euribor 1V + 3.5% por jo më pak se 3.5% dhe jo më të lartë se 6%. Huaja do të disbursohet sipas skedulit në vijim:

- 1,500,000euro brenda 31 dhjetor 2018;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2019;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2020;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2021;
- 500,000 euro brenda 31 dhjetor 2022.

Gjatë 2018 and 2019, Shoqëria ka disbursuar shumën prej 2,000,000 euro e cila në datën e raportimit është ekuivalente me 243,540,000 lekë.

Në datën e raportimit pjesa afatgjatë e kredisë së dhënë është 243,540,000 lekë (2018: 185,130,000 lekë) ndërsa pjesa afatshkurtër është 7,420,420 lekë (2018: Lek 2,838,043 lekë).

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 10. Inventarët

Inventarët më 31 dhjetor 2019 and 2018 mund të përmbliidhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Produkte të gatshme	179,868,090	64,275,670
Mallra	49,360,139	28,473,805
Materiale të para	64,683,791	99,605,581
Materiale të para në tranzit	5,753,843	2,531,698
Materiale të tjera	12,326,276	13,166,345
Produkte të bllokuara	(18,198,370)	-
<b>Totali</b>	<u><b>293,793,769</b></u>	<u><b>208,053,099</b></u>

Gjatë tremjorit të fundit të vitit, Shoqëria, ka rritur inventarin e produktit të gatshëm, në përputhje me investimet e planifikuara dhe parashikimet e shitjeve për periudhën tremujori 4-të 2019 – tremujori 1-rë 2020. Ky vendim bazohet në investimin e planifikuar për sallën e re të shurupit. Investimi filloi në nëntor 2019 dhe duhet të përfundojë në prill 2020.

### 11. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfaqesojnë të arkëtueshmet nga shitja e produkteve dhe mallrave. Në fund të vitit nuk u njoh zhvlerësim për të arkëtueshmet tregtare..

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga shitja e produkteve	853,174	21,595,965
Të arkëtueshme të tjera	5,204,835	2,811,485
<b>Totali</b>	<u><b>6,057,835</b></u>	<u><b>24,407,450</b></u>

### 12. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Uji i Ftohte Tepelene Shpk	18,355,335	10,175,838
SIBEG Srl	4,194,489	14,456,431
S.A. Coca-Cola Services	-	32,349,369
Crilu Shpk	-	22,500
<b>Totali</b>	<u><b>22,549,824</b></u>	<u><b>57,004,138</b></u>

Shoqëria merr pjesë në programe të ndryshme marketingu të mbështetura nga S.A. Coca-Cola Services (CCS). Sipas këtyre programeve, një pjesë e shpenzimeve të Shoqërisë rimbursohen nga CCS (shih shënimin 23).

## Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 13. Aktive të tjera

Aktivitet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 mund të përmbliken si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të pafaturuara	29,107,170	-
Parapagime ndaj furnitorëve	12,369,935	39,277,348
Shpenzime të parapaguara	10,865,262	15,886,299
Interesa të përllogaritur	7,525,535	2,838,043
Tatime	1,280,344	-
Të tjera	381,789	243,952
<b>Totali</b>	<b><u>61,530,035</u></b>	<b><u>58,245,642</u></b>

Të ardhurat e pafaturuara, përfaqësojnë konstatime për fatura ende të pa lëshuara ndaj Coca-Cola Services për rimbursimin e shpenzimeve të programeve të marketingut.

#### 14. Depozita me afat

Depozitat me afat më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Depozita me afat	395,310,000	458,216,840
<b>Totali</b>	<b><u>395,310,000</u></b>	<b><u>458,216,840</u></b>

Në datën 31 dhjetor 2019, depozitat me afat në lekë të Shoqërisë përbëhen nga depozita prej 30 milionë lekë (2018: 26 milionë lekë), të cilat mbartin normën vjetore të interesit prej 1.4% dhe depozita prej 365.31 milionë lekë, ekuivalente me 3 milionë euro (2018: 3.5 milionë euro) që ka norma vjetore të interesit prej 0.01%. Kjo e fundit, e vendosur si garanci bankare në emër të ACIES (shoqëria mëmë) nga Shoqëria tek Intesa San Paolo Bank. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të humbjes së kreditit nuk është konsideruar material.

Depozitat me afat janë në Banka të cilat kanë vlerësimin P2 dhe P3 (Prime) nga Moody's.

#### 15. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në banka rezidente	433,819,103	173,322,968
Mjete monetare në arkë	1,494,164	1,140,297
Depozita me afat maturimi më pak se 3 muaj	-	1,700,000
<b>Totali</b>	<b><u>435,313,267</u></b>	<b><u>176,163,265</u></b>

Paratë në banka rezidente, mbahen në banka me vlerësim P2 and P3 (Prime) by Moody's. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit dhe analiza e ndjeshmërisë të aktiveve dhe detyrimeve financiare janë të përfshira në shënimin 27.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 16.Kapitali i paguar

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 1,493,040,000 mijë lekë (2018: 1,493,040,000 lekë). Struktura e kapitalit të paguar përbëhet nga 1 kuotë prej 1,115,151,756 lekë, 1 kuotë prej 338,173,560 lekë dhe 1 kuotë prej 39,714,864 lekë. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, interesat e pjesëmarrjes në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar përfaqësohen nga ortakët, të cilët mbajnë vetëm një kuotë. Kuota përfaqëson pjesëmarrjen e ortakëve në kapitalin e shoqërisë dhe çdo kuotë mbart të drejtën e votës në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të përfaqësuar nga kuota.

Më poshtë jepet përmbledhja e strukturës së kapitalit të Shoqërisë:

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Numri i kuotave	Pjesëmarrja në %	Lekë	Numri i kuotave	Pjesëmarrja ne %	Lekë
SIBEG	1.00	74.69	1,115,151,576	1.00	74.69	1,115,151,576
TCCEC	1.00	22.65	338,173,560	1.00	22.65	338,173,560
Invest P.F.	1.00	2.66	39,714,864	1.00	2.66	39,714,864
	<b>3.00</b>	<b>100</b>	<b>1,493,040,000</b>	<b>3.00</b>	<b>100</b>	<b>1,493,040,000</b>

### Dividendët

Ortakët zotërojnë të drejtën e përfitimit të dividendit të deklaruar dhe të drejtën e votës në mbledhjet e përgjithshme të Shoqërisë, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota. Të gjitha të drejtat e votimit në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota renditen në mënyrë të barabartë lidhur me aktivet e mbetura të Shoqërisë.

Me 16 prill 2019 mbledhja e Asamblesë së Ortakëve aprovoi shpërndarjen e dividendit për vitin fiskal 2018.

Fitimi neto i vitit 2018	486,763,484
Dividend të paguar gjatë 2019	(486,763,484)
Dividend të pagueshëm më 31 dhjetor 2019	-

### 17.Rezerva ligjore

Sipas ligjit të mëparshëm shqiptar të shoqërive tregtare, shoqërive tregtare u kërkohet të transferonin minimalisht pesë përqind të të ardhurave neto vjetore, siç paraqitet në pasqyrat financiare, në rezerva ligjore, derisa kjo rezervë të barazonte një të dhjetën e kapitalit të nënshkruar dhe kjo rezervë nuk mund të shpërndahej. Më 14 prill 2008 në Shqipëri hyri në fuqi një ligj i ri për shoqëritë tregtare, i cili nuk kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të njohin ndonjë rezerve për qëllime ligjore. Përdorimi i këtyre rezervave ligjore është në vullnetin e ortakëve.

### 18.Rezerva të tjera

Para vitit 2012, Ortakët e Shoqërisë në mënyrë unanime kanë aprovuar transferimin e 5% të fitimit neto të çdo viti, në rezerva të tjera. Përdorimi i këtyre rezervave të tjera është në vullnetin e ortakëve.

## Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 19.Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Detyrimi ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet si vijon:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Uji i Ftohte Tepelene Shpk	5,951,151	2,366,308
ACIES Srl	2,611,130	9,692,566
SIBEG Srl	222,135	1,537,713
Crilu Shpk	-	655,104
	<b>8,784,416</b>	<b>14,251,691</b>

#### 20.Llogari të pagueshme

Detyrimet ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
<b>Të huaj</b>		
Materiale të para	130,548,991	95,425,822
Shpenzime kapitale	39,149,055	-
Mallra	8,994,771	133,060
Të tjera	21,455,962	20,779,014
<b>Vendas</b>		
Materiale të para	11,325,522	1,816,471
Shpenzime kapitale	45,100,301	-
Të tjera	46,304,024	27,829,300
	<b>302,878,626</b>	<b>145,983,667</b>

Shoqëria i siguron materialet e para kryesisht nga furniturë të huaj. Detyrimet ndaj furnitorëve të huaj për materiale të para më 31 dhjetor 2019, përbëhen nga zërat si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Kanace	55,018,997	17,144,367
Preforma PET	30,114,274	14,866,294
Koncentrat	20,083,682	42,523,223
Sheqer	13,297,284	16,975,187
Tapa	6,155,059	3,296,615
Anhidrid karbonik	5,128,539	395,512
Etiketa	751,156	224,624
<b>Totali</b>	<b>130,548,991</b>	<b>95,425,822</b>

Në datën e raportimit, Shoqëria ka detyrime ndaj furnitorëve vendas dhe të huaj për shpenzime kapitale, kryesisht për shkak të investimit në proces për sillën e re të shurupit, i cili ka filluar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 dhe parashikohet të mbarojë në prill 2020. Investime të tilla përfshijnë furnitorë lokal për të kryer punimet civile dhe furnitorë të huaj për instalimet e pajisjeve të reja.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 21. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfshijnë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Parapagime nga klientët	69,371,202	39,040,618
TVSH e pagueshme	42,529,258	39,109,844
Të pagueshme ndaj personelit	38,018,151	40,646,605
Të tjera	20,577,099	5,792,029
Tatimi mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore	18,280,614	18,996,817
Shpenzime të përlllogaritura	10,295,102	19,042,278
<b>Totali</b>	<b>199,071,426</b>	<b>162,628,191</b>

### 22. Të ardhura nga kontratat me klientë

Të ardhurat nga aktiviteti operativ analizohen si më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
<i><b>Te ardhurat nga shitja e produkteve te veta</b></i>		
Coca-Cola	1,749,109,614	1,648,549,533
Fanta Exotic	996,987,507	863,478,982
Fanta Orange	751,935,378	667,718,026
Coca-Cola zero	122,178,276	119,302,877
Sprite	91,531,336	91,222,083
Schweppes	45,829,606	48,210,869
Fanta Lemon	20,898,873	24,811,883
Fanta Seasonal	17,247,085	23,918,566
	3,795,717,675	3,487,212,819
<i><b>Te ardhura nga shitja e mallrave tregtare</b></i>	166,924,289	180,342,755
<b>Totali</b>	<b>3,962,641,964</b>	<b>3,667,555,574</b>

Shoqëria lançon çdo vit shije sezonale për Fanta, të cilat janë në dispozicion vetëm për periudhën e verës. Gjatë vitit 2019 shija sezonale Fanta ishte Fanta zero Peach apricot (2018: Fanta Mango & Dragon fruit). Të ardhurat nga shitja e mallrave janë shitje të ujit, lëngje frutash, çaji dhe pijeve energetike të prezantuara në tregun shqiptar nga Shoqëria. Shoqëria njihet të ardhura nga shitja e mallrave në një moment të caktuar në kohë. Zbritjet mbi shitjet njihen në bazë të marrëveshjeve me distributorët ose me klientet kyç. Shoqëria ka paraqitur të ardhurat neto nga uljet e çmimit të produkteve.

### 23. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera analizohen si më poshtë:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Rimbursimi i kostove për programe marketing	202,853,244	171,902,625
Shitja e materialeve dhe shërbimeve	58,363,704	44,168,255
Të ndryshme	941,909	4,437,878
<b>Totali</b>	<b>262,158,857</b>	<b>220,508,758</b>

Shoqëria merr pjesë në programe të ndryshme marketingu, ku një pjesë e këtyre kostove rimbursohen nga Coca-Cola Services. “Rimbursimi i kostove për programet e marketingut” përfshin shumën të dhëna nga Coca-Cola Services në vlerën 202,251 mijë lekë (2018: 169,134 mijë lekë). Shoqëria mbart përgjegjësinë kryesore në organizimin dhe krijimin e aktiviteteve të marketingut dhe të promocioneve dhe realizimi i këtyre aktiviteteve është nën vullnetin e plotë të Shoqërisë.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 24. Shpenzimet sipas natyrës

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, paraqitet sipas funksionit. Të njëjtat shpenzime janë paraqitur në këtë shënim sipas natyrës.

<i>Shpenzimet sipas natyrës</i>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Blerje materiale të para	1,777,273,326	1,578,699,322
Blerje mallra	178,420,810	166,319,792
Materiale të tjera të përdorura në prodhim	104,491,180	109,110,545
Taksa dhe shpenzime doganore	54,294,364	117,007,796
Ndryshim në inventar	(154,326,838)	(23,752,752)
Inventar i nxjerrë jashtë përdorimi	79,112,009	19,581,467
Shpenzime transporti të brendshme	56,711,721	63,472,747
Shpenzime transporti të jashtme	58,891,882	52,669,954
Riparime dhe mirëmbajtje	51,875,736	45,338,090
Sigurime	6,997,143	3,114,827
Taksa kombëtare dhe lokale	5,347,895	5,470,083
Shpenzime për qira afatshkurtra	18,376,254	-
Shpenzime qira operative për aktive afatgjata materiale	-	71,236,990
Shpenzime të tjera personeli	9,937,062	11,437,309
Gjoha dhe të tjera	540,195	4,934,806
Paga	473,412,619	451,143,637
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	59,506,448	54,505,657
Udhëtime dhe dieta	10,509,797	8,934,873
Shpenzime marketing dhe reklame	220,497,177	208,043,990
Shërbime konsultimi dhe të tjera profesionale	89,677,774	97,050,779
Shpenzime të flotës së automjeteve	42,387,511	42,110,343
Vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale jashtë përdorimi	19,314,397	10,234,766
Shpenzime sigurimi	9,394,392	8,650,876
Shpenzime telekomunikacioni	8,526,655	7,580,479
Pajisje zyre	3,381,479	3,312,483
Shpenzime administrative	5,143,522	3,417,325
Amortizimi i aktiveve më të drejtë përdorimi	68,731,519	-
Amortizime të AAM	144,850,052	142,943,934
Të tjera	17,270,699	15,385,153
<b>Totali</b>	<b>3,420,546,780</b>	<b>3,277,955,271</b>



# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 25. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare paraqiten si më poshtë:

	2019	2018
<b>Shpenzime financiare</b>		
Shpenzime interesi	(2,649,452)	-
Komisione bankare	(2,173,143)	(2,146,326)
Humbjet neto nga kursi i këmbimit	(6,696,280)	(37,387,655)
	<b>(11,518,875)</b>	<b>(39,533,981)</b>
<b>Te ardhura financiare</b>		
Te ardhura nga dividendi	1,692,043	885,600
Te ardhura nga interesi	7,747,681	3,810,009
	<b>9,439,724</b>	<b>4,695,609</b>
<b>Shpenzimet Neto</b>	<b>(2,079,151)</b>	<b>(34,838,372)</b>

### 26. Tatim fitimi

	2019	2018
Tatim fitimi aktual për vitin	126,177,056	87,374,912
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	(2,487,418)	1,132,293
	<b>123,689,638</b>	<b>88,507,205</b>

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme duke përdorur normën prej 15% (2018: 15%). Tatimi mbi fitimin në Shqipëri llogaritet me normën prej 15% të të ardhurave të tatueshme. Më poshtë jepet një rakordim i tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit mbi fitimin.

	%	2019	%	2018
Fitimi përpara tatimit		802,174,890		575,270,689
Tatim fitimi duke përdorur normën e aplikueshme	15	120,318,054	15	86,290,603
Shpenzime të pazbritshme	0.4	3,363,404	0.4	2,216,602
Të ardhura të përjashtuara nga tatimi	0.0	-	0.0	-
	<b>15.4</b>	<b>123,689,638</b>	<b>15.4</b>	<b>88,507,205</b>

Drejtimi, bazuar në legjislacionin ekzistues në fuqi beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme dhe se çdo kontroll tatimor i ardhshëm nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e operacioneve, ose flukset e mjeteve monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit të tatimit mbi të ardhurat, praktikave dhe udhëzimeve të lidhura, nuk është e mundur të sigurohemi që pozicioni ligjor aktual i ligjit mbi taksat do të mbetet i pakontestueshëm nga autoritetet tatimore.

## Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

## 26. Shpenzimi i tatim fitimit (vazhdim)

Tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve shpërndahe si më poshtë:

	Aktive		Detyrime		Njohur në fitim/humbje 2018
	2018	2017	2018	2017	
Aktive afatgjata materiale		-	(28,565,178)	(27,868,467)	(696,711)
Investime në letra me vlerë të kapitalit	600,000	600,000	-	-	-
Inventarë	-	340,566	-	-	(340,566)
Shpenzime të përlllogaritura	686,424	781,440	-	-	(95,016)
	<b>1,286,424</b>	<b>1,722,006</b>	<b>(28,565,178)</b>	<b>(27,868,467)</b>	<b>(1,132,293)</b>

	Aktive		Detyrime		Njohur ne fitim/humbje 2019
	2019	2018	2019	2018	
Aktive afatgjata	-	-	(29,306,618)	(28,565,178)	(741,441)
Aktive me të drejtë përdorimi	-	-	(11,280,974)	-	(11,280,974)
Investime në letra me vlerë të kapitalit	600,000	600,000	-	-	-
Inventar	2,729,755	-	-	-	2,729,756
Aktive të tjera	1,604,189	-	-	-	1,604,189
Detyrime qiraje	9,659,990	-	-	-	9,659,990
Shpenzime të përlllogaritura	1,202,323	686,424	-	-	515,899
	<b>15,796,257</b>	<b>1,286,424</b>	<b>(40,587,593)</b>	<b>(28,565,178)</b>	<b>(2,487,418)</b>

## 27. Menaxhimi i rrezikut financiar

### (a) Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka paraqitur vlerën e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare të tjera të cilat nuk maten me vlerë të drejtë, sepse vlera e mbetur e tyre është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

Drejtimi përdor të gjithë informacionin mbi performancën dhe operimin e investimeve të mundshme pas datës së njohje fillestare (shënimi 2).

### (b) Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

#### (i) Struktura e administrimit të rrezikut

Drejtimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për drejtimin e rrezikut. Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Shoqëria mëmë mbikëqyr se si drejtuesit monitorojnë përpuethshmëritë e politikave, procedurave të administrimit të rrezikut të Shoqërisë me ato të grupit, si dhe rishikon përshtatshmërinë e kuadrit të administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet më të cilat përballet Shoqëria. Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat e parave në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

#### (ii) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale që lidhet kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit të kredisë. Maksimumi i ekspozimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor	
	2019	2018
Të arkëtueshme tregtare	6,057,835	24,407,450
Aktive të tjera	381,789	2,838,043
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	29,970,244	57,004,138
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	435,313,267	176,163,265
Huadhënie	243,540,000	185,130,000
Depozita me afat	395,310,000	458,216,840
	<b>1,110,573,135</b>	<b>903,759,736</b>

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit, sipas tipit të rajonit gjeografik ishte:

	31 dhjetor	
	2019	2018
Vendas	1,893,423	24,407,450
	<b>1,893,423</b>	<b>24,407,450</b>

#### *Të arkëtueshmet tregtare*

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, drejtimi gjithashtu konsideron faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në rrezikun e kredisë të bazës së saj të klientëve, duke përfshirë rrezikun e dështimit të industrisë.

Drejtimi ka vendosur një politikë kredie sipas të cilës çdo klient i ri është analizuar individualisht për aftësinë paguese para se të ofrohen kushtet standarte të pagesës dhe dorëzimit. Shqyrtimi i Shoqërisë përfshin vlerësimet e jashtme, nëse ato janë në dispozicion, pasqyrat financiare, informacionet e industrisë dhe në disa raste referencat bankare. Shoqëria monitoron rregullisht situatën financiare të klientëve të saj.

Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë nga të arkëtueshmet tregtare duke përcaktuar afatet e pagesës për secilën kategori të klientëve dhe shpërndarësit trajtohen me parapagim dhe duke ofruar garanci bankare në emër të Shoqërisë, për qëllime kredie gjatë sezonit të lartë. Klientët e drejtpërdrejtë menaxhohen përmes marrëveshjeve të cilat kanë terma fikse për sa i përket shumës së kredisë dhe planeve të ripagimit .

Kufijtë e shitjes janë përcaktuar për çdo klient dhe rishikohen në baza periodike. Çdo shitje që tejkalon këto kufizime kërkon miratimin nga Administratori i Shoqërisë.

Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë nga të arkëtueshmet tregtare duke vendosur një maksimum pagese prej 10 deri 30 ditësh për klientët e saj. Shoqëria ka qenë e lidhur me klientët kryesorë për vite dhe nuk është njohur asnjë humbje nga zhvlerësimi ndaj këtyre klientëve / dhe asnjë nga këto bilance të klientëve nuk janë shlyer ose janë të dëmtuara nga kreditimi në datën e raportimit. Në monitorimin e rrezikut të kredisë për klientët, konsumatorët grupohen sipas karakteristikave të tyre të kreditit, vendndodhjes së tyre gjeografike, historisë tregtare me kompaninë dhe ekzistencën e vështirësive financiare të mëparshme.

Shoqëria nuk kërkon kolateral në lidhje me llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për të arkëtueshmet tregtare në datat e raportimit është tërësisht i lidhur me klientët me shitje me shumicë dhe të arkëtueshme nga shitja e mbetjeve të riciklueshme dhe të tjera.

#### *Vlerësimi i humbjes së pritshme të kredisë për konsumatorët*

Shoqëria ka zgjedhur të matë humbjet e zbritshme për të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshmet nga palët e lidhura në vlerën e humbjeve të pritshme të kredisë përgjatë jetës, duke përdorur matricën e provizionit në të cilën humbjet e pritshme llogariten duke u bazuar në normat e humbjes së pritshme për të arkëtueshmet në bazë të maturitetit të tyre.

Normat e humbjes së pritshme bazohen në natyrën e pagesave të shitjes dhe në humbjet e pritshme historike të ndodhura gjatë kësaj periudhe. Normat historike të humbjes rregullohen në mënyrë që të pasqyrojnë informacionin aktual dhe të ardhshëm mbi faktorët makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer detyrimet. Shoqëria ka identifikuar PBB dhe normën e papunësisë së vendeve ku shet mallra dhe shërbime si faktorët më të rëndësishëm dhe në përputhje me rrethanat rregullon normat historike të humbjes bazuar në ndryshimet e pritshme të këtyre faktorëve. Normat e humbjes llogariten veçmas për ekspozime në segmente të ndryshme bazuar në karakteristikat e rrezikut të kredisë.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbje 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit të mjeteve monetare dhe ekuivalente të tyre. Me 31 dhjetor 2019, për shkak të ekspozimit afatshkurtër, Shoqëria nuk ka njohur zhvlerësim në pasqyrat financiare.

#### Huadhënie

Shoqëria i ka dhënë hua një pale të lidhur. Kjo nuk e ekspozon Shoqërinë kundrejt rrezikut të kredisë, dhe nuk është e reflektuar në pasqyrat financiare.

#### (iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi për të përmbushur detyrimet financiare të cilat shlyhen nëpërmjet pagesave në mjete monetare ose nëpërmjet një aktivi tjetër financiar. Shoqëria gjithashtu monitoron nivelin e flukseve monetare hyrëse të pritshme nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera së bashku me nivelin e flukseve monetare dalëse të pritshme nga llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera. Shoqëria gjeneron flukse monetare të mjaftueshme nga aktivitetet operacionale aq sa beson se rreziku i likuiditetit nuk është i rëndësishëm.

Më poshtë janë maturitetet e mbetura kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Shumat janë bruto dhe të paskontuara, dhe përfshijnë cdo pagesë kontraktuale interesi deri me 31 dhjetor 2019 and 2018:

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
Të arkëtueshme tregtare	6,057,835	6,057,835	-	-
Aktive të tjera afatshkurtra	7,525,535	7,525,535	-	-
Të arkëtueshme tregtare	22,549,824	22,549,824	-	-
Depozita me afat	395,310,000	-	395,310,000	-
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	435,313,267	435,313,267	-	-
Huadhënie	243,540,000	-	-	243,540,000
	<b>1,110,296,461</b>	<b>471,446,461</b>	<b>395,310,000</b>	<b>243,540,000</b>
<i>Detyrime financiare</i>				
Detyrime ndaj palëve të lidhura	8,784,416	8,784,416	-	-
Të pagueshme tregtare	302,933,159	302,933,159	-	-
Detyrime qiraje	64,399,929	-	40,913,207	23,486,722
Detyrime të tjera	48,313,253	48,313,253	-	-
	<b>424,430,757</b>	<b>360,030,828</b>	<b>40,913,207</b>	<b>23,486,722</b>
<b>Neto</b>	<b>685,865,704</b>	<b>111,415,633</b>	<b>354,396,793</b>	<b>220,053,278</b>

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
Të arkëtueshme tregtare	24,407,450	24,407,450	-	-
Aktive të tjera	2,838,043	2,838,043	-	-
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	57,004,138	57,004,138	-	-
Depozita me afat	458,216,840	-	458,216,840	-
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	176,163,265	176,163,265	-	-
Huadhënie	185,130,000	-	-	185,130,000
	<b>903,759,736</b>	<b>260,412,896</b>	<b>458,216,840</b>	<b>185,130,000</b>
<i>Detyrime financiare</i>				
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14,251,691	14,251,691	-	-
Të pagueshme tregtare	145,983,667	145,983,667	-	-
Detyrime të tjera	59,688,883	59,688,883	-	-
	<b>219,924,241</b>	<b>219,924,241</b>		
<b>Neto</b>	<b>683,835,495</b>	<b>40,488,655</b>	<b>458,216,840</b>	<b>185,130,000</b>

#### (iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë edhe kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumentave të saj financiarë.

#### Rreziku nga kursi i këmbimit

Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në euro kundrejt furnitorëve të saj, që e ekspozon Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria nuk përdor instrumente derivativ për t'u mbrojtur ndaj këtij rreziku.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	EUR	USD	Lek
Të arkëtueshme tregtare	6,057,835	4,164,412	-	1,893,423
Aktive të tjera	7,525,535	7,420,420	-	105,115
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	22,549,824	4,194,489	-	18,355,335
Depozita me afat	395,310,000	365,310,000	-	30,000,000
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	435,313,267	230,143,292	31,232	205,138,743
Huadhënie	243,540,000	243,540,000	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(8,784,416)	(2,833,265)	-	(5,951,151)
Të pagueshme tregtare	(302,933,159)	(200,148,779)	-	(102,784,380)
Detyrime të tjera	(48,313,253)	-	-	(48,313,253)
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>750,265,633</b>	<b>651,790,569</b>	<b>31,232</b>	<b>98,443,832</b>

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Vlera			
	kontabël	EUR	USD	Lek
Të arkëtueshme tregtare	24,407,450	1,778,536	-	22,628,914
Aktive të tjera	2,838,043	2,838,043	-	-
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	57,004,138	46,805,800	-	10,198,338
Depozita me afat	458,216,840	432,216,840	-	26,000,000
Mjete monetare	176,163,265	32,206,115	67,868	143,889,282
Huadhënie	185,130,000	185,130,000	-	-
Detyrime ndaj paleve të lidhura	(14,251,691)	(11,230,280)	-	(3,021,411)
Detyrime ndaj furnitoreve	(145,983,667)	(122,524,573)	(101,008)	(23,358,086)
Të pagueshme tregëtare	(59,688,883)	-	-	(59,688,883)
Ekspozimi neto	<b>683,835,495</b>	<b>567,220,481</b>	<b>(33,140)</b>	<b>116,648,154</b>

Më poshtë jepen kurset e këmbimit të aplikuar gjatë vitit:

Lekë	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2019	2018	2019	2018
<i>USD 1</i>	109.86	107.99	108.64	107.82
<i>EUR 1</i>	123.00	127.53	121.77	123.42

### Analiza e ndjeshmërisë

Në administrimin e normave të interesit dhe rrezikut të monedhës, Shoqëria synon të pakësojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra mbi fitimet e Shoqërisë. Në afatgjatë, gjithsesi ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normës së interesit mund të japin ndikim në fitim. Më poshtë paraqitet një analizë e ndikimit të parashikuar në ndryshimet në përqindjen e normës së interesit dhe ndryshimeve në vlerën në Lek kundrejt monedhave të tjera.

### Profili

Në datën e raportimit, profili i instrumentave financiar të Shoqërisë që mbartin interes jepet si më poshtë:

Instrumentat financiarë me norma fikse	31 dhjetor	
	2019	2018
Aktivet financiare	638,850,000	645,046,840

Aktivet financiare përfshijnë depozitat me afat dhe huadhënien në datën e raportimit.

### Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentat me normë fikse

Shoqëria nuk bën regjistrime për aktivet apo detyrimet financiare me normë fikse të mbajtura vlerën e drejtë nëpërmjet fitim ose humbjes, dhe Shoqëria nuk ka instrumenta derivative (swap për normat e interesit) si instrumenta mbrojtëse sipas një modeli kontabël mbrojtës të vlerës së drejtë. Kështu që një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në fitim ose humbje.

Një ndryshim me 100 pikë në normën e interesit do të rriste ose zvogëlonte kapitalin me 5,595 mijë lekë (2018: 5,426 mijë lekë).

Një forcim ose dobësim i Lekut kundrejt Euro-s dhe USD-së më 31 dhjetor 2019 do të zvogëlonte ose rriste përkatësisht kapitalin dhe fitimin ose humbjen sipas shumave të paraqitura më poshtë. Kjo analizë bazohet në ndryshimet e kurseve të këmbimit me 10% që Shoqëria konsideron të arsyeshëm në fund të datës raportuese. Analiza është bërë mbi baza të njëjta edhe për 2019.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Lek	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Kapital	Fitim ose Humbje	Kapital	Fitim ose Humbje
USD	2,655	2,655	(2,817)	(2,817)
EUR	55,402,198	55,402,198	48,207,066	48,207,066

#### (v) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Drejtimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si raporti i të ardhura operative neto ndaj totalit të kapitalit. Drejtimi dhe Bordi i Drejtorëve monitoron gjithashtu nivelin e dividendëve për aksionet e zakonshme.

Nuk ka ndryshime në qasjen e Shoqërisë për administrimin e kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

### 28. Angazhime dhe detyrime të mundshme

#### Çështje ligjore

##### Mosmarrëveshjet mbi tokën me qira

Siç është paraqitur në shënimin 1 dhe 6, Qeveria e Shqipërisë ka marrë pjesë përmes Invest P.F. duke kontribuar në natyrë përdorimin e tokës në pronësi të saj për një periudhë 99 vjeçare. Pavarësisht pronësisë së Qeverisë shqiptare, një grup prej 15 individësh shqiptarë pretenduan në Gjykatën e Rrethit Tiranë se ata janë ish pronarë të tokave dhe aktualisht mbajnë vërtetime pronësinë mbi tokën e kontribuar nga Qeveria e Shqipërisë.

Shoqëria ka paraqitur një kërkesë në prefekturën e Tiranës për të verifikuar dhe anuluar këto vërtetime pronësinë mbi tokën të këtyre individëve shqiptarë, duke shkaktuar një hetim administrativ, i cili arriti në përfundimin se këto vërtetime janë të pavlefshme. Për më tepër, prefektura e Tiranës inicioi procedurat përkatëse gjyqësore duke i kërkuar Gjykatës së Tiranës të anulojë zyrtarisht vërtetime të tilla.

Për 10 çështje gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit ka mbështetur vendimin e Gjykatës Administrative të Tiranës që ka konstatuar pavlefshmërinë e veprave të pronësisë së individëve dhe ka urdhëruar anulimin e këtyre pretendimeve. Individët e kanë apeluar këtë vendim në Gjykatën Supreme, e cila deri më tani nuk ka caktuar një datë për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Prefekti ka kërkuar ekzekutimin për 10 vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe tashmë ka filluar rregullimet përkatëse të regjistrimit të vërtetimeve të pronësisë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, Zyra e Tiranës. 8 prej këtyre vërtetimeve janë regjistruar tashmë në pronësi të shtetit shqiptar, ndërsa 2 të tjerat mbeten ende në proces.

Për 3 çështje gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit vendosi që çështjet të kthehen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Tiranës. Individët e kanë apeluar këtë vendim në Gjykatën Supreme, e cila deri më tani nuk ka caktuar një datë për gjykimin e këtyre çështjeve.

Për 2 raste gjyqësore, për shkak të çështjeve të trashëgimisë, Prefektura e Tiranës vendosi të heqi dorë nga gjykimi i padisë për të rifilluar procedurën administrative për anulimin e titullit përkatës të pronësisë.

Bazuar në këshillat juridike, drejtimi beson se të gjitha rastet do të jenë të suksesshme dhe nuk ka asnjë provizion të vlerësuar dhe njohur në pasqyrat financiare, pasi nuk ekziston probabiliteti që të kërkohej pagesë për zgjidhjen e padisë.



# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 28. Angazhime dhe detyrime të mundshme (vazhdim)

#### *Pagesat minimale të qirasë në të ardhmen*

Angazhimet për qiranë e ndërtesës dhe automjeteve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Më pak se 1 vit	70,900,335
Mbi 1 vit dhe më pak se 5 vjet	46,564,105
Mbi 5 vjet	-
<b>Totali</b>	<u><u>117,464,440</u></u>

#### *Huadhënie*

Gjatë 2018, Shoqëria ka lidhur një kontratë huaje me ACIES me datë maturimi 31 dhjetor 2024 me interes vjetor Euribor 12 mujor +3.5% por jo më pak se 3.5% dhe jo më shumë se 6%. Shumat e huasë per tu disbursuar jane si vijon:

- 1,500,000 euro brenda 31 dhjetor 2020;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2021;
- 500,000 euro brenda 31 dhjetor 2022.

### 29. Palët e lidhura

Shoqëria ka një marrëdhënie si palë e lidhur me ortakët e saj, me shoqërinë mëmë, dhe me shoqëri të tjera që janë nën kontrollin e shoqërisë mëmë përfundimtare ACIES. Shoqëria ka gjithashtu marrëdhënie si palë të lidhura edhe me drejtuesit dhe ekzekutivët e saj.

Gjatë vitit ka patur transaksione me:

- TCCEC - aksioner
- ACIES Srl – shoqëria mëmë
- SIBEG Srl. – aksioner – nën kontrollin e ACIES
- Invest PF/ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. - aksioner
- Crilu Shpk – nën kontrollin e ACIES
- Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk – nën kontrollin e ACIES

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 29.Palët e lidhura (vazhdim)

Gjatë vitit Shoqëria kishte këto transaksione me palët e lidhura:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
<b>Blerje nga:</b>		
ACIES	142,340,397	133,815,104
Uji i Ftohtë Tepelenë	66,547,795	91,623,130
SIBEG	20,954,300	21,791,408
Crilu	6,012,311	8,294,039
<b>Shitje ndaj:</b>		
Uji i Ftohte Tepelene	54,271,159	39,835,047
SIBEG	8,184,281	14,618,191
Crilu	303,124	398,602
ACIES	-	-
<b>Të ardhura të tjera (Shënimi 23)</b>		
S.A. Coca-Cola Services	202,250,935	169,134,402
<b>Të ardhura financiare (Shënimi 8,9)</b>		
<i>Të ardhura nga interesi</i>		
ACIES	7,420,420	2,838,043
<i>Te ardhura nga dividendët</i>		
Uji i Ftohtë Tepelenë	1,692,043	885,600

Në çdo datë raportimi, në pasqyrën e pozicionit financiar janë përfshirë vlerat e mëposhtme për palët e lidhura:

<i>Të arkëtueshme / (Të pagueshme)</i>	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga Crilu	-	22,500
Të pagueshme ndaj Crilu	-	(655,103)
Të arkëtueshme nga Uji i Ftohte Tepelene	18,355,335	10,175,838
Të pagueshme ndaj Uji i Ftohte Tepelene	(5,951,151)	(2,366,308)
Të arkëtueshme nga S.A. Coca-Cola Services	-	32,349,368
Të arkëtueshme nga SIBEG	4,194,489	14,456,431
Të pagueshme ndaj SIBEG	(222,135)	(1,537,713)
Të pagueshme ndaj ACIES	(2,611,130)	(9,692,566)
	<u>13,765,408</u>	<u>42,752,447</u>

Gjithashtu Shoqëria ka dhënë një hua ndaj ACIES në shumën 243,540 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2019 (2018: 185,130 mijë lekë).

Drejtuesit e Shoqërisë kanë marrë shpërblime vjetore në shumën 50,624 mijë lekë per vitin 31 dhjetor 2019 (2018: 52,269 mijë lekë).

Gjithashtu Shoqëria ka vendosur depozita me afat si garanci në emër të palës së lidhur ACIES në një bankë vendase (shih shenimin 14)

# Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K.

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

---

### 30. Ngjarje pas datës së raportimit

Në fund të vitit 2019 në Kinë shpertheu COVID – 19 (Coronavirus). Në fund të vitit një numër i limituar rastesh me një virus të panjour është raportuar në OBSH. Në muajt e parë të vitit 2020 u përhap vrullshëm në gjithë botën. Që nga fillimi i muajit mars distancimi social është në fuqi në Shqipëri. Qeveria ka marrë disa masa për të zvogeluar impaktin e Coronavirusit në popullsinë e vendit. Këtu përfshihen lëvizja e kufizuar, qëndrimi në shtëpi i popullsisë, dhe mbyllja e bizneseve jo shumë të domosdoshme, të cilat priten të kenë një impakt negativ në rezultatin e Shoqërisë. Duke qenë se kjo situatë është ende në zhvillim në kohën që janë lëshuar këto pasqyra financiare, nuk ka ndikim të dukshëm në operimin e zakonshëm të Shoqërisë, gjithsesi efekte të ardhshme nuk mund të parashikohen.

Drejtimi e konsideron këtë ngjarje të mëvonshme si event që nuk kërkon rregullim të pasqyrat financiare.

Drejtimi do të vazhdojë të monitorojë impaktin potencial dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të minimizuar çdo efekt të mundshëm. Vlen për tu theksuar fakti se Shoqëria ka azhornuar planet e vazhdimësisë së biznesit, ka marrë masa parandaluese për të mbrojtur stafin e saj, për të garantuar që vendi i punës është i sigurtë dhe për të ruajtur gjendjen e parave. Shoqëria ka një bilanc të qëndrueshem dhe likuiditet të mjaftueshëm për të patur në dispozicion mjete monetare në mënyrë të menjëhershme.

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që kërkon rregullim apo shënim shtesë në pasqyrat financiare.

### 31. Politika kontabël për qiratë përpara 1 janar 2019

Politikat kontabël të aplikueshme për periudhën krahasuese të mbyllur më 31 dhjetor 2018 të cilat janë ndryshuar nga SNRF 16, *Qiratë*, janë si vijon.

**Qiratë operative.** Kur Shoqëria është një qiramarrës në një qira e cila nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi të Shoqëria, totali i pagesave të qirasë njihen në fitim ose humbje të vitit në baza lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Afati i qirasë është një periudhë e paanullueshme për të cilën qiramarrësi ka hyrë në një kontratë për të marrë me qira aktivin duke përfshirë edhe kushtet nga të cilat qiramarrësi ka opsionin të vazhdojë qiranë, me ose pa pagesa të mëtejshme, kur ka siguri të arsyeshme në fillim të qirasë se qiramarrësi do ta ushtrojë atë të drejtë.

Kur aktivet janë dhënë si qira operative, pagesat e arkëtueshme të qirasë njihen si e ardhur nga qiraja në baza lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë.

**Detyrimet e qirasë financiare.** Kur Shoqëria është një qiramarrës në një qira e cila transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi të Shoqëria, aktivet e marra me qira kapitalizohen në aktive afatgjata materiale në fillim të qirasë në vlerën më të ulët mes vlerës së drejtë të aktivitetit me qira dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Çdo pagesë qiraje qëndron midis detyrimit dhe tarifave financiare në mënyrë për të arritur një normë konstante për balancën e mbetur. Detyrimet përkatëse të qirasë, neto nga tarifat e ardhshme financiare, përfshihen në huamarrje. Shpenzimi i interesave njihet në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Aktivet nga qiraja financiare amortizohen me jetën e tyre të dobishme ose me afatin e qirasë, nëse Shoqëria nuk ka siguri të arsyeshme se do të ketë pronësi në fund të afatit të qirasë.